



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

KLIMA E INVESTIMEVE 2018, MBI INSPEKTIMET

Tiranë, Janar 2019

Ky dokument pune është përgatitur nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve në kuadër të mbledhjes XV të Këshillit të Investimeve (29 janar 2019), znj. Mimoza Agolli, eksperte për ekonominë dhe z. Elvis Zerva, ekspert ligjor, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni). Redaktimi gjuhësor i materialit dhe përkthimi (anglisht-shqip) i disa pjesëve u realizua nga znj. Elisa Lula, oficere administrative dhe komunikimit e Sekretariatit. Falenderojmë për bashkëpunimin dhe kontributin e veçantë subjektet private, përfaqësuesit e institucioneve qendrore (Ministria e Drejtësisë, Gjykata Administrative, Ministria e Financave dhe Ekonomisë) dhe institucioneve lokale, përfaqësuesit e Inspektoriatit të Mbikqyrjes së Tregut (znj. Ejana Xhixha, Kryeinspektore), Kryeinspektorin e Përgjithshëm, Inspektoriatin e Punës dhe Shërbimeve, Agjencinë e Kontrollit të Ushqimit, etj.

www.investment.com.al

LISTA E SHKURTIMEVE

AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
DAT	Drejtoria e Apelimit Tatimor
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IKMT	Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
IQ	Inspektoriati Qendror
ISH	Inspektoriati Shtetëror
ISHMPUT	Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit
ISHMT	Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
ISHPSHSH	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
IShSh	Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë
ISHTI	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial
KI	Këshilli i Investimeve
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
RIA	Vlerësimi i Impaktit të Riskut (angl. Risk Impact Assessment)



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
KONTEKSTI	7
METODOLOGJIA	9
ANALIZA DHE GJETJE	10
1. KUADRI STRATEGJIK DHE KAPACITETET INSTITUCIONALE	10
2. ANKIMIMI ADMINISTRATIV	14
3. KOORDINIMI NDËR-INSTITUCIONAL	22
REKOMANDIME	26
SHTOJCA	30
BIBLIOGRAFIA	35

HYRJE

Reforma e derregullimit mbetet një nga reformat më sfiduese për transformimin e ekonomisë shqiptare drejt një ekonomie tregu. Inspektimet konsiderohen një element thelbësor i reformës, si një mekanizëm kyç për zbatimin në praktikë të ligjeve dhe që synon të përmirësojë përputhshmërinë me kuadrin rregullator. Në thelb, një reformë sistemike e inspektimeve përfshin mjaft procese dhe institucione, dhe pavarësisht nga modeli që ndiqet, fokusohet në tre aspekte: (i) ligjore, (ii) institucionale, (iii) sistemet e informacionit¹. Nëse reforma zbatohet mirë, ajo rezulton në uljen e “barrës administrative” mbi bizneset, rrit potencialet për eksporte dhe vënde të reja pune, si edhe mundëson përfitime nga vendosja e shtetit ligjor.

Në raportin e BE-së për Shqipërinë (2018) theksohet se “*pavarësisht progresit në reformën e inspektimeve dhe përmirësimit të kuadrit ligjor, parashihet domosdoshmëria e përmirësimit dhe përafrimit të legjislacionit sektorial me legjislacionin e BE-së*”. Raporti thekson gjithashtu nevojën e përmirësimit të kapaciteteve institucio-

nale, burimeve njerëzore, logjistikës dhe kapaciteteve laboratorike si domosdoshmëri për të forcuar funksionin e inspektimit, monitorimit të zbatueshmërisë së kuadrit rregullator nga agjentët ekonomikë dhe jo vetëm. Procesi mbetet tepër sfidues për vendin në kushtet kur mbështetja dhe mbikëqyrja e duhur rregullatore dhe monitoruese e procesit janë garanci të domosdoshme për të përmbushur detyrimet e Shqipërisë në kuadrin e integritetit evropian. Sipas studimit të OECD², *ri-organizimi i shërbimit publik nëpërmjet procesit të digjitalizimit - duke përfshirë në dizënjimin dhe zbatimin e procesit të digjitalizimit edhe biznesin dhe grupet e tjera të interesit - do të rezultonte në mekanizma lehtësues të barrës së biznesit*. Kjo lidhet sidomos me kostot e përputhshmërisë së biznesit me ndryshimet rregullative që sjellin reformat strukturore dhe sistemike që po ndërmerren nga Shqipëria në kuadrin e integritetit evropian.

Në kuadrin e konsultimit me biznesin dhe rekomandimeve (2015-2018) për përmirësimin e klimës së investimeve në vend, KI ka sjellë në vëmendje të politikëbërjes prioritetin e ndërhyrjeve në lidhje me përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të administratës publike ndaj biznesit duke vënë theksin tek institucionet, kuadrin ligjor apo edhe informatizimin e shërbimeve. Konkretisht, përveç analizave mbi inspektimin tatimor, informalitetin, etj., në vitin 2016, KI diskutoi përmirësimin e mekanizmave të zgjidhjes së

¹ Roli i inspektimit në zbatimin e legjislacionit me fokus kryesor në inspektimin e lidhur me biznesin në Serbi (2017), faqe 13 - Botuar nga Qendra Ballkanike për Reformën Rregullatore, Projekti i USAID-it për Mundësimin e Biznesit, Instituti i Shkencave Ekonomike

² Parimet e Praktikës më të Mirë të OECD mbi Angazhimin e Palëve të Interesit në Politikën Rregullatore, 2017

mosmarrëveshjeve midis bizneseve dhe administratës publike³, ku një pjesë e rekomandimeve preknin specifikisht aspekte ligjore dhe institucionale që aktualisht mund të themi janë në një trajektore pozitive. Theksojmë se këto analiza bazoheshin në të dhëna të Gjykatës së Apelit Administrativ të cilat evidentonin se *bizneset kishin numrin më të lartë të mosmarrëveshjeve me administratën tatimore dhe doganore të ndjekura nga çështje mes bizneseve dhe inspektoriateve, edhe pse këto të fundit ishin në peshë relative mjaft të ulët.*

Në anketimin për klimën e investimeve⁴ për vitin 2018 nga ana e Sekretariatit, bizneset vlerësuan se zbatimi i legjislacionit dhe marrëdhënia me administratën publike perceptohet të jetë lehtësues i investimeve në nivel të moderuar, me vlerësim respektiv 3,42 nga 5 për bazën ligjore dhe 3,62 nga 5 për marrëdhënien e biznesit me administratën publike. Ky perceptim risjell në vëmendje faktin se zbatimi në praktikë i legjislacionit si edhe marrëdhënia mes biznesit dhe administratës publike ka hapësira për t'u përmirësuar.

Bazuar në sa më lart, si edhe në vijim të analizave në lidhje me rolin e administratës publike si rregullator i tregut, ky material sjell

3 Mbledhja Nr. 4 “Për Përmirësimin e Mekanizmave të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve midis Biznesit dhe Administratës Publike”. Analiza u bazua në të dhëna mbi numrin e ankimeve administrative të regjistruara si në komisionet e shqyrtimit të ankimeve administrative brenda institucioneve ashtu edhe të numrit të padive të biznesit të regjistruara në Gjykatat Administrative të të gjitha shkallëve për 2014 dhe 2015.

4 Anketa e Klimës së Investimeve e realizuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve, realizohet si mekanizëm/instrument i mbledhjes dhe evidentimit të perceptimit të biznesit në mënyrë të strukturuar për të evidentuar problematikat më kryesore në lidhje me inspektimin tatimor, TVSH, komunikimin me administratën tatimore dhe doganore, informalitetin. Në lidhje me klimën në përgjithësi, evidenton edhe problematika që lidhen me licencimin, marrëdhëniet me administratën publike, kualifikimin e punonjësve apo procedurat/kostot e kredimarrjes, etj. Anketimi është realizuar gjatë periudhës 2015-2018, me pjesëmarrjen në të tre vitet të rreth 577 bizneseve nga gjithë sektorët ekonomikë në nivel kombëtar.

në mënyrë sintetike një përmbledhje të zhvillimeve në reformën e inspektimit duke u përqendruar në ato aspekte të inspektimit që ndikojnë klimën e biznesit dhe investimeve. Analiza mbështetet në të dhëna të mbledhura nga konsultimet me bizneset nga Sekretariati gjatë periudhës 2015-2018, të dhëna administrative të publikuara nga Inspektoriati Qendror apo inspektoriatet e veçanta; të dhënat e vëna në dispozicion të Sekretariatit nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë. Ky material nuk ka për qëllim të shterojë të gjitha problematikat lidhur me inspektimin apo Reformën e Inspektoriateve në Shqipëri e cila është ende në proces.

Objektivi kyesor është të risjellë në vëmendje faktin se çështjet e inspektimit dhe inspektoriateve mbeten po aq prioritare sa edhe formalizimi i ekonomisë me synim garantimin e rregullave të njëjta në treg, mbrojtjen e konkurrencës së ndershme, mbrojtjen e konsumatorit dhe ambientit.

Një analizë më e thelluar e inspektimeve, duke përfshirë kostot e tij për biznesin do të jetë fokus i punës së KI gjatë 2019.

KONTEKSTI

Reforma e inspektoriateve, e filluar në kuadër të reformës së de-rregullimit, po hyn në dhjetëvjeçarin e parë të zbatimit. Qeveria ndërmori reformën e inspektimit në vitin 2008, pasi vlerësimet mbi efektivitetin e inspektimeve ishin mjaft të ulëta dhe kostot e barrierat të shkaktuara prej inspektimeve mbi veprimtarinë ekonomike dhe jo-ekonomike të agjentëve të tregut ishin të larta. Sipas Bankës Botërore (2013)⁵, bizneset raportonin se inspektoheshin mesatarisht 13,8 herë brenda një viti nga 14 inspektorate të ndryshme, ndërkohë që inspektorët shpenzonin mesatarisht 45 ditë pune pranë çdo biznesi. Gjithashtu trupat inspektuese, në tërësinë e tyre ishin të fragmentuara, të pa-koordinuara, me mungesa në rregullore dhe udhëzime të detajuara e të qarta dhe me mangësi lidhur me metodat moderne të inspektimeve⁶.

5 World Bank (2013), Albania - Business Environment Reform and Institutional Strengthening Project (English). Washington DC; World Bank.

6 Jacques Tallineau and Igor Gutan (2009) “Reform of Inspection System in Albania”, p.6

Sipas literaturës (2008)⁷, konfirmohet korrelacioni dhe impakti i një mjedisi të favorshëm ligjor e rregullator në rritjen ekonomike dhe tërheqjen e IHD-ve, ndërkohë që theksi vihet *mbi rolin e rëndësishëm të koordinimit me efikasitet të “mirëqeverisjes rregullatore”* duke filluar me: a) hartimin e rregullave, b) forcimin dhe zbatimin e duhur të tyre në praktikë, c) monitorimin dhe vlerësimin që shërben si bazë për përmirësimin e ligjeve e rregullave ekzistuese dhe d) hartimin e rregullave të reja.

Nën asistencën e Bankës Botërore nëpërmjet projektit “*Business Environment Reform & Institutional Strengthening (BERIS) 2007-2012*” u mbështetën institucionet shqiptare për të krijuar kapacitete për ndërmarrjen e reformave të nevojshme për përmirësimin e klimës së biznesit. Një ndër arritjet e projektit ishte dhe **rishikimi i kuadrit institucional të inspektimeve duke reduktuar numrin e ISH nga 34 në 12, hartimi i ligjit mbi inspektimin (Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011) dhe krijimi i IQ në Shtator 2011.**

7 Busse and Groizard (2008)

Roli i IQ është koordinues dhe rregullator për të gjitha ISH, si dhe për të garantuar se veprimtaria inspektuese do të jetë në frymën e ligjit dhe në koherencë të plotë me objektivat strategjike të tij: a) bashkërendimi i inspektimeve; b) ulja e barrës administrative të inspektimeve për bizneset, si dhe c) rritja e efektivitetit të inspektimeve.

1. INSTITUCIONET DHE LEGJISLACIONI:

- a) ***IQ⁸ midis të tjera ka edhe këto funksione bazë:***
- » miraton rregulla të përgjithshme bazë për metodologjinë e vlerësimit të riskut, programimin e inspektimeve, dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve;
 - » krijon dhe mban një portal unik të inspektimit, që shërben për programimin dhe bashkërendimin e inspektimeve, shkëmbimin e të dhënave ndërmjet inspektorateve të ndryshme, si dhe për informimin e publikut;
 - » mbikëqyr zbatimin e këtij ligji dhe të ligjit të posaçëm nga inspektorët shtetërorë, për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimit të inspektimit, dhe ka të drejtë të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj inspektorëve dhe Kryeinspektorit Shtetëror, në rast të vërejtjes së shkeljeve prej këtyre të fundit.

b) ***Ligj Nr. 10433, datë 16.06.2011 solli disa risi në lidhje me:***

- » Mënyrën e organizimit të inspektorateve në nivel vendor dhe qendror, parimeve të inspektimit dhe raporteve institucionale midis ISH dhe IQ.
- » Ligji centralizoi në një institucion të vetëm koordinimin rregullator dhe metodologjik të një sërë inspektorateve të pavarura sipas fushave të përgjegjësisë të ministrive të ndryshme.
- » Vendosi disa garanci bazë mbi kohëzgjatjen e inspektimit të planifikuar. Konkretisht në Nenin 26/2 parashikon se: *“Periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor është nga 5 deri në 15 ditë”*.
- » Sanksionoi parimet bazë të inspektimit në funksion të uljes së barrës së biznesit duke vendosur detyrimin për inspektoriatet për të bërë njoftimin paraprak të biznesit mbi kryerjen e inspektimeve (Neni 32)⁹.

Theksojmë që prej 2017, ka një iniciativë për të progresuar me Reformën e Inspektorateve në kuadër të reformës derregullatore. Pas reformimit të inspektimit, është e rëndësishme një analizë e impaktit të reformës në aspektin rregullator dhe kostove të biznesit për të ndërtuar një *roadmap* të reformës në vazhdim. Aktualisht janë 16 ISH që janë subjekt i koordinimit të IQ, për të cilat janë publikuar edhe listat e inspektorëve në detyrë.

⁹ Inspektimi i njoftohet nëpërmjet njoftimit paraprak të autorizimit të subjektit të inspektimit jo më vonë se 3 ditë përpara fillimit të veprimeve të inspektimit.

METODOLOGJIA

Metodologjia e hartimit të kësaj note teknike, bazohet në katër shtylla metodike, konkretisht në (i) *konsultimin e literaturës*, (ii) *mbledhja e të dhënave administrative*, (iii) *identifikimi i perceptimit të biznesit nëpërmjet anketimit*, si dhe (iv) *konsultimet e Sekretariatit që nga 2015 me përfaqësues të institucioneve/inspektorateve që kanë rezultuar si më problematikë në gjykata ndaj biznesit*. Sikurse u theksua më lart, ky punim përbën një hap të parë, drejt një analize më të thelluar në 2019 dhe synon të tërheqë vëmendjen mbi rëndësinë e reformës dhe momentit kritik në kuadër edhe të integritetit të vendit në 2019.

- a) ***Konsultimi i literaturës***. Nota teknike bazohet në konsultimin e gjerë të literaturës, dokumentave zyrtarë të institucioneve të lidhura me funksionin e inspektimit, konkretisht IQ, 16 inspektoriatet, ministrinë e linjës dhe legjislacionin sektorial. Eksperiencat rajonale, studime dhe raporte të institucioneve ndërkombëtare në hartimin dhe zbatimin e reformave derregullatore janë konsultuar dhe kanë ndihmuar në paraqitjen e situatës dhe parashtrimin e sfidave/problemeve.
- b) ***Të dhëna administrative të raportuara nga institucionet***. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga burime të ndryshme që ushtrojnë funksione rregullatore dhe monitoruese të inspektimit si IQ, ministrinë përgjegjëse për 16 Inspektoriatet pjesë e sistemit aktual të inspektimit, DPT dhe DAT, MFE, MB, Platformës së Bashkëqeverisjes dhe Gjykatës Administrative (Shkalla e Parë dhe Apelit). Të dhënat administrative të mbledhura synojnë

- të identifikojnë: (i) volumin dhe dinamikën e inspektimeve të kryera nga inspektoriatet, (ii) masat administrative të ndërmarra¹⁰, (iii) raportin e tyre me volumin e inspektimeve dhe (iv) shpërndarjen sipas inspektorateve¹¹.
- c) ***Mbledhja e perceptimit të biznesit nëpërmjet anketimit***. Perceptimi i biznesit në lidhje me klimën e investimeve në përgjithësi, dhe në veçanti ndikimi i marrëdhënieve të biznesit me administratën publike. Anketimi përfshiu 357 biznese, të shpërndara në gjithë vendin, të përzgjedhura rastësisht nga një databazë prej 10 mijë biznese të identifikuar nga DPT dhe QKB¹².
- d) ***Konsultime***. Konsultime dhe intervista me 24 përfaqësues të inspektorateve dhe biznesit.

¹⁰ Masat administrative të përmendura në këtë notë teknike janë dënimet administrative apo sanksionet administrative në varësi të terminologjisë në legjislacionin përkatës sektorial të cilat përfshijnë: gjobat, pezullimet e aktivitetit apo mbyllja e përkohshme, mbylljet përfundimtare të aktivitetit, si edhe çdo dënim tjetër kryesor apo plotësues të parashikuar nga legjislacionet sektoriale.

¹¹ Të dhëna administrative për të parë raste të mosmarrëveshjeve mes palëve dhe funksionimin e mekanizmit administrativ apo gjyqësor të zgjidhjes janë mbledhur nga inspektoriatet, Gjykata Administrative e Apelit dhe portali i bashkëqeverisjes.

¹² Bazuar në kriteret statistikore të përcaktimit të kampionit, pyetësori ka një shkallë sigurie statistikore 95%, dhe gabim në matje në masën 5%, në referencë me popullatën e kompanive prej 107.000. Shpërndarja është e barazpeshuar mes qarqeve, përjashtim bën Tirana. 59,3% e bizneseve të anketuara raportojnë xhiro vjetore nën 8 Mio Lek, 69,7% e kompanive deklarojnë numër punonjësish deri në 50 të punësuar dhe vetëm 10,4% e kompanive kanë kapital të huaj. Shumica e bizneseve operojnë në sektorin e shërbimeve duke përfshirë turizmin, shërbimet financiare dhe konsulente, shërbime teknike ndërkohë që tregtia dhe ndërtimi zënë gati 19% të kampionit të kompanive.

ANALIZA DHE GJETJE

Gjetjet nuk janë shteruese për të gjitha problematikat e kontrollit/inspektimit dhe nuk përgjithësojnë të gjitha organet rregullatore/inspektoriatet, por janë grupuar sipas problematikave të evidentuara nga bizneset dhe Sekretariati i KI gjatë funksionimit të tij. Analiza e të dhënave është bërë duke patur në konsideratë të dhënat për inspektimet dhe të dhënat për kontrollet dhe apelimin tatimor. Gjetjet në vijim të analizës janë grupuar në tre shtylla që lidhen me: 1. Kuadrin Strategjik dhe Kapacitetet Institucionale; 2. Ankimin Administrativ; 3. Koordinimin Institucional.

1. KUADRI STRATEGJIK DHE KAPACITETET INSTITUCIONALE


Bizneset e anketuara nëpërmjet pyetësorit mbi “Klimën e Investimeve 2018”¹³ i realizuar nga Sek-

13 Anketa e Klimës së Investimeve e realizuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve, realizohet si mekanizëm/instrument i

retariati, konfirmojnë se mirëfunksionimi i tregut ndikohet ndjeshëm nga konkurrenca e padrejtë (72%), praktikat korruptive (92%), pajtueshmëria me kërkesat ligjore (78% e bizneseve) si dhe marrëdhënia me administratën (81%) (shih fig. 1). Bizneset e anketuara raportuan se *zbatimi i legjislacionit dhe marrëdhënia me administratën publike perceptohet “të lehtësojë investimet” në nivel të moderuar*. Baza ligjore e zbatuar në praktikë perceptohet të jetë lehtësuese dhe nxitëse e investimeve në masën 3,42 nga 5 që është vlerësimi optimal, ndërkohë që marrëdhënia me administratën publike vlerësohet të jetë nxitëse në masën 3,62 nga 5 (shih shtojcën 2).

mbledhjes dhe evidentimit të perceptimit të biznesit në mënyrë të strukturuar për të evidentuar problematikat me kryesore në lidhje me inspektimin tatimor, TVSH, komunikimin me administratën tatimore dhe doganore, informalitetin. Në lidhje me klimën në përgjithësi, evidenton edhe problematika që lidhen me licencimin, marrëdhëniet me administratën publike, kualifikimin e punonjësve apo procedurat/kostot e kredimarrjes, etj. Anketimi është realizuar gjatë periudhës 2015-2018, me pjesëmarrjen në të tre vitet të rreth 577 bizneseve nga gjithë sektorët ekonomikë në nivel kombëtar.

Figura 1. Faktorët përcaktues të perceptimit të biznesit mbi mirëfunksionimin e tregut



Burimi: Përpunim i Sekretariatit nga Anketa e KI 2018

1. Sigurisht që inspektoriatet janë një pjesë e rëndësishme e administratës publike me të cilën përballen bizneset. Kjo përballje influencon edhe perceptimin e biznesit mbi rolin e administratës si rregullator i tregut. Ndonëse ka dinamika pozitive në aspektin formal të reformimit të inspektimeve, në aspektin përmbajtësor ka akoma hapësira për përmirësim duke shmangur mbivendosje kompetencash dhe funksionesh midis inspektoriateve të ndryshme dhe duke forcuar koordinimin ndër-institucional. Rishikimi i legjislacionit sektorial dhe koherenca në shpërndarjen e kompetencave janë faktorë që akoma pengojnë optimizimin e efikasitetit të reformës. Në këtë fazë ku ka mbërritur zbatimi i reformës së inspektimit, si pjesë e asaj derregullatore, ndoshta kërkohet një rigjallërim i angazhimit politik dhe dokumentave strategjike të reformës duke bërë publik modelin dhe planin e masave apo aktiviteteve në vazhdimësi.
2. **Struktura institucionale e inspektimit në Shqipëri ka ndryshuar rrënjësisht që nga viti 2010.** Kompetencat e inspektimit ngelen funksion i qeverisjes qendrore, ministrive dhe inspektoriateve të cilat janë institucione të varësisë së tyre. Inspektimi koordinohet dhe monitorohet nga Inspektoriati Qendror i krijuar në 2011. Në fillimet e ristrukturimit të inspektoriateve, u kalua nga 34 inspektoriate në vetëm 8 të tillë. Aktualisht numri i ISH është 16. **Numri i inspektoriateve rezultoi në një trend rritës krahasuar me pikën fillestare të reformës pavarësisht bashkimit të disa prej tyre**¹⁴. Nga përpjekjet për të kuptuar volumin e inspektimit nëpërmjet statistikave zyrtare vihej re një *kalim i kompetencave të inspektimeve nga një inspektoriat në tjetrin* (p.sh. inspektoriati i ujërave). Paqën-


14 Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave” u bashkua me “Inspektoriatin e Turizmit” sipas VKM Nr. 338 datë 06.06.2018.

drueshmëria në shpërndarjen e kompetencave të inspektoriateve si dhe numri në rritje i tyre bien ndesh me frymën e reformës e cila ka konsistuar në rritjen e efektivitetit të inspektimit me një numër sa më të ulët të inspektoriateve.

3. Aktualisht numri total i inspektimeve të raportuara, si shumë e inspektimeve të realizuara nga çdo inspektoriat, në 2017 vlerësohet në 83.000 inspektime (shih Fig. 2). **Trendi në rënie i numrit të inspektimeve, tregon se ka përpjekje për të krijuar një klimë pozitive biznesi dhe për të mos rritur kostot administrative të tyre nga kontrollet e shumta.** Këto kosto, të matura në numër ditësh në vit në të cilat një biznes duhet të inspektohet, janë ulur në 15 ditë nga 59 ditë që ka qënë para fillimit të reformës. Në 2017, rreth 16% e inspektimeve janë realizuar nëpërmjet platformës së e-inspektimit, duke përmirësuar ndjeshëm efektivitetin e inspektimit në terma kohore dhe reduktimit të praktikave të korrupsionit. Progresi në këtë drejtim, me rritjen e raportit të inspektimeve *online* në raport me totalin e inspektimeve do të vazhdojë të sjellë ndikim pozitiv në efektivitetin e reformës.

4. Nga analiza e shpërndarjes së inspektimeve gjatë 2017 rezultojnë se inspektoriatet që përballojnë volumnin më të madh të inspektimeve janë Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë (ISHSH), Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) si dhe Inspektoriati i Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (SHPSHS). Rezultojnë në rritje roli i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve (shih Fig. 3).


Figura 2. Dinamika e inspektimeve 2013-2017



Burimi: Të dhënat administrative nga raportet vjetore të Inspektoriatit Qendror (2013-2017)

Shpërndarja e inspektimeve gjatë 2017 tregon se inspektoriatet që përballojnë volumnin më të madh të inspektimeve janë ISHSH, ISHTI, SHPSHS, ndërkohë që rezultojnë në rritje roli i SHMPUT (shih Fig. 3). **Duke krahasuar volumnin e inspektimeve me numrin e bizneseve, mesatarisht çdo biznesi aktiv i takon të kalojë një inspektim teknik vjetor.** Ndërkohë, bizneset në anketimin për klimën e biznesit kanë raportuar se numri mesatar i inspektimeve tatimore ka qënë 2,1 (në 2017), dhe prevalenca e kontrolleve ka qënë 53%, duke rezultuar në një frekuencë mesatare të inspektimit tatimor në vlerën 1,1 inspektime për çdo biznes aktiv, të njëjtë me atë të inspektimeve të tjera (shih Shtojcën 4).


Figura 3. Shpërndarja e inspektimeve sipas inspektoriateve 2015-2017



Burimi: Përpunim i Sekretariatit nga të dhënat e raporteve të IQ

5. Të dhënat administrative tregojnë se rreth 2% e inspektimeve kanë përfunduar me aplikimin e masave administrative, si pezullim/mbyllje e aktivitetit ekonomik, masa për përmirësim teknik, gjoba apo edhe ndjekje penale. **Ndër masat administrative 64% kanë qënë masa administrative në gjobë, raporti i gjobave ndaj masave administrative rezultojnë të jetë dyfishi i këtij raporti në krahasim me 2014.** Rritja e numrit të masave administrative kërkon konsolidimin e mekanizmit të ankimimit të tyre (shih Fig. 4).
6. Ndër inspektoriatet, shkalla më e lartë e raportit të gjobave kundrejt masave administrative është raportuar nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (100%), Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor (93%) si dhe Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (84%) (shih Shtojcën 5). Raporti vjetor i vitit 2017 nuk përfshin informacion për AKU, ndërkohë që disa inspektoriate nuk kanë raportuar të dhëna mbi masat administrative apo gjobat. Vlera e gjobave të vëna (dhe të raportuara) për vitin 2017 raportohet në 343 Mio Lekë, ndërkohë që mbledhja e tyre raportohet të jetë shumë problematike dhe për shumë inspektoriate niveli i arkëtimeve është shumë i ulët (shih Shtojcën 5).

Figura 4. Masat Administrative dhe Gjjobat e vendosura nga Inspektimet, 2013-2017



Burimi: Të dhëna administrative, Raporti Vjetor i Inspektoriatit Qendror (2013-2017)

2. ANKIMIMI ADMINISTRATIV

1. **Ankimi si e drejtë e garantuar.** E drejta për ankimi në rrugë administrative tek një organ i posaçëm ankimi/apelimi epror është e garantuar nga ana formale-juridike, duke qenë e parashikuar në të gjitha ligjet që zbatohen nga ana e institucioneve të sipërpërmendura¹⁵.


15 E drejta e ankimit është e rregulluar nga dispozitat e mëposhtme:
Ankimet administrative në fushën e procedurave tatimore: Nenet 38 dhe 106 e vijues të Kreut III të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSh" (i ndryshuar)
Ankimet administrative në fushën doganore: Neni 289 i Ligjit Nr.8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë". Kjo dispozitë është aktualisht në fuqi dhe mbetet e tillë deri më 1 Qershor 2017, datë në të cilën do të hyjnë në fuqi dispozitat e Kodi të Ri Doganor të miratuar me Ligjin Nr. 102/2014 datë 31.07.2014.
Ankimet administrative në fushën e inspektimeve: Neni 51 i Ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; dispozitat konkrete të VKM-ve përkatëse në

Rregullat e ankimit administrativ ndaj akteve administrative janë përgjithësisht të sistemuara duke qenë të identifikueshme nga ana e biznesit nëpërmjet një kërkimi të thjeshtë në përmbajtjen e ligjeve. Këto të fundit pavarësisht ndryshimeve midis tyre në mënyrën e formulimit reflektojnë parimet bazë mbi të cilat duhet të bëhet shqyrtimi i ankimeve administrative.

2. Në raport me numrin e masave administrative të vendosura nga Inspektoriatet, numri i ankimeve administrative brenda inspektoriateve është i ulët.

bazë të të cilave krijohen organizohen dhe funksionojnë inspektoratet përkatëse si edhe dispozitat e ligjeve material të zbatuara nga ana e secilit inspektoriat.
Ankimet administrative në fushën e prokurimeve publike: Neni 63 e vijues të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar)

Figura 5. Ankimimet e masave administrative të inspektoriateve



Burimi: Përpunim i Sekretariatit¹⁶

Gjatë vitit 2017 rezultoi se vetëm 6% e masave administrative të vendosura nga inspektoriatet ankimohen në mënyrë administrative. Ndërkohë që ky raport për rastin e masave administrative të zbatuara nga administrata tatimore pas kontroleve sipas raportimit të bizneseve të anketuara është 14%. Prevalenca e ankimeve tatimore është më e lartë se mesatarja e përgjithshme tek kompanitë e mëdha¹⁷ xhiro mbi 8 Mio Lek dhe numër punonjësisht mbi 50, për të cilat raportohet në masën 21,8%, mes kompanive që operojnë në sektorin prodhues dhe përpunues (50%), turizëm si dhe mes profesionistëve të lirë (20%).

16 Të dhëna nga gjykatat e apelit

17 Kompani të mëdha, për efekt klasifikimi në këtë studim i referohet kompanive me xhiro vjetore mbi 8 Mio Lek dhe numër punonjësisht mbi 50.

3. Raporti i ulët i ankimit administrativ të raportuar në të dhënat dhe raportet zyrtare të IQ, lidhet me nivelin e limituar të transparencës/informimit, vështirësitë për bizneset (veçanërisht të vogla) për të kuptuar procedurat e ankimit të brendshëm të një mase administrative sipas inspektoriateve, si edhe mungesën e besimit tek komisionet e shqyrtimit të ankimeve. Komisionet e Apelimit në varësi të institucionit kanë emërtime të ndryshme, p.sh. Drejtoria e Apelimit Tatimor (DAT)/Komisioni i Shqyrtimit të Apelimeve Tatimore (KSHAT) për ankimet që lidhen me procedurat tatimore, Komisioni i Shqyrtimit të Gjobjave (ISHTI) apo Komisioni i Shqyrtimit dhe Vlerësimit të Ankimeve (AKU). Me disa përjashtime, si në rastin e DAT¹⁸ apo AKU¹⁹ të cilat paraqesin informacion mbi strukturën e apelimit në faqet e tyre zyrtare në internet, për strukturat e tjera të apelimit në institucione (si p.sh. KSHAT) apo inspektoriate (ISHTI) nuk ka një informacion të tillë. **Pothuajse në të gjitha rastet mungon transparenca e plotë mbi rregullat, procedurat, afatet që lidhen me shqyrtimin e ankimeve administrative, vendimet e publikuara apo raportet periodike mbi numrin e masave administrative të vendosura, atyre të ankimeve dhe atyre të shfuqizuara ose lënë në fuqi.** Madje ka ende inspektoriate si ISHMPUT të cilat nuk disponojnë ende një faqe zyrtare. IQ²⁰, DAT²¹ dhe KPP²² kanë të publikuara disa forma standarde lidhur me ankimin administrativ duke dhënë një asistencë të arsyeshme për subjektet, në lidhje me ankimin administrativ. Në faqen zyrtare të ISHPSSH-së jepet

18 <http://financa.gov.al/drejtoria-e-apelimit-tatimor/>

19 http://aku.gov.al/?page_id=2022

20 Forma standarde inspektimi- Ankesë për vendimin përfundimtar

21 Formulari i apelimit tatimor

22 Formulari i Ankesës Për Prokurimin


informacion për sanksionet e zbatueshme ndaj biznesit pas vendimit përfundimtar të inspektimit. Ndërkohë që po punohet për të mundësuar publikimin e anëtarësisë së Komisionit të Apelimit si edhe njoftimet për datat e shqyrtimit të këtyre ankimeve, elementë të rëndësishëm që lidhen me apeline të tilla si transparenca dhe edukimi i biznesit në lidhje me mekanizmat e ankimit administrativ, mbeten ende të nevojshëm.

4. **Ankimi administrativ si mjet juridik për të kundërshtuar aktet e administratës në këto struktura shikohet nga biznesi më tepër si një kusht apo fuxë paraprake e detyrueshme, që duhet të përmbushet me qëllim që më pas t'i drejtohen gjykatave administrative**²³. Vendimet e komisioneve të ankimeve, shpeshherë janë të paragjykuara për shkak të mënyrës së krijimit, or-

23 Në parim, palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ.

ganizimit dhe funksionimit të tyre të përcaktuar nga ligji dhe për shkak të elementëve të "konfliktit të interesit" që kanë trupat kolegjiale që merren me shqyrtimin e ankimeve, duke qenë pjesë e të njëjtës institucion që ka vendosur masën administrative. Vendimet për shfuqizimin e masave administrative të inspektoriateve përfaqësojnë vetëm 14% të tyre (në vlerë) gjatë 2017. **Ky raport i ulët i vendimeve pro-biznesit në rast ankimi për inspektoriatet, sjell dekurajim të biznesit për të ankimuar masat administrative.** Ndërkohë në Anketën "Klima e Investimeve" (2017), biznesi ka raportuar se vetëm për 24% të vlerës së ankimeve për rivlerësimet nga administrata tatimore, vendimet e strukturave të shqyrtimit të apelineve kanë qenë në favor të tyre. Ky perceptim duket se konfirmohet edhe nga të dhënat zyrtare të DAT sipas të cilave 21% e rasteve të ankimeve janë shfuqizuar (shih Fig. 6).

Figura 6. Numri i ankimeve tatimore të shfuqizuara dhe të lëna në fuqi nga DAT



2018* Përmban të dhënat e 6-mujorit të dytë të 2018
Burimi: Përpunim i Sekretariatit²⁴

24 Të dhëna nga DAT

Lehtësimi i procedurave të ankimit administrativ dhe ristrukturimi i apelimit tatimor është shoqëruar me një prevalencë 2 herë më të lartë të biznesit për të përdorur rrugët administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me administratën publike në rolin e rregullatorit dhe monitoruesit të tregut. Modeli i apelimit tatimor, si një rast i praktikave më të mira edhe pse i ristrukturuar rishtaz, mund të konsiderohet për t'u adoptuar edhe nga inspektoriatet.

5. **Ankimet administrative jo gjithmonë shqyrtohen në mënyrë efektive brenda komisioneve të ankimit.** Nga analiza e Sekretariatit dhe nga informacionet e mbledhura nga ekspertët e fushës dhe bizneset, konstatohet se në mjaft raste *ankimet administrative nuk shqyrtohen në mënyrë efektive brenda komisioneve të ankimit dhe në përputhje me parashikimet e KPrA*. Kjo lidhet me disa arsye të cilët në mënyrë të përmblodhur jepen si më poshtë:

- » *Në mjaft raste nuk ka seanca të mirëfillta të rishikimit të brendshëm administrativ apo të shqyrtimit të ankimit administrativ.* Përveç Drejtorisë së Apelimit Tatimor të cilat ndjekin një procedurë tashmë të konsoliduar në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve për çështjet e ankimeve duke ju dhënë mundësi ankimesve për t'u dëgjuar si edhe për të paraqitur prova dhe argumenta, strukturat e tjera të apelimit mjaftohen me shqyrtimin e akteve shkresore të paraqitura nga palët. Ndërkohë, komisionet e ankimit në inspektoriate mjaftohen vetëm me shqyrtimin e akteve shkresore të paraqitura nga palët pa praninë e tyre ose kjo mundësohet vetëm kur një gjë e tillë kërkohet nga pala që ka paraqitur

ankimin (p.sh. AKU). Sipas Rregullores së IQ *"Për Përcaktimin e Procedurës së Inspektimit, si një Proces i Rregullt Administrativ"*²⁵ *shqyrtimi i ankimit duhet të bëhet detyrues në prani të subjektit ankimes, duke nxitur kryerjen e seancave dëgjimore në kuadër të ankimit të paraqitur nga subjekti. Edhe pse është e pamundur që çdo shqyrtim ankimi të bëhet në prani të subjektit, për shembull për arsye se subjekti mund të refuzojë të marrë pjesë (rast që Rregullorja nuk e ka parashikuar) standardi që duhet të ndiqet për shqyrtimin administrativ të ankimeve duhet të jetë minimalisht ai i parashikuar nga KPrA. Për të rritur transparençën e procesit të shqyrtimit administrativ ndihmon edhe parashikimi i paragrafit 35 të Rregullores sipas të cilës: "Të gjitha etapat e dokumentuara të shqyrtimit të procedurës së ankimit nga Trupa Kolegjiale ngarkohen në sistemin e-inspektimit, nga sekretari dhe juristi i Trupës Kolegjiale".*

- » *Kompetencat e parashikuara në ligjet e posaçme për institucione të ndryshme lënë vend për interpretime.* Edhe në rastin kur këto kompetenca janë të mirëpërcaktuara sërish komisionet e ankimit vendosin në kapërcim të këtyre kompetencave. Kjo vjen si rezultat i faktit se këto struktura apelimi nuk njohin parimet dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, por janë të prirura që në mënyrë të ngurtë të zbatojnë vetëm dispozitat e ligjit të posaçëm mbi bazën e të cilit ato organizohen dhe funksionojnë.

25 Dokument i miratuar me Urdhërin Nr.25 Datë 10.08.2018 të Inspektorit të Përgjithshëm

Në jo pak raste, vetë dispozitat e ligjeve/udhëzimeve të posaçme janë në kundërshtim me ato të Kodit të Procedurave Administrative të cilat në çdo rast duhet të kenë përparësi meqenëse janë pjesë e një ligji në shkallë hierarkie më të lartë²⁶ se ligjet e thjeshta.

- » *Në mjaft raste administrata nuk interpreton dispozitat ligjore të legjislacionit në kushtet e mirëbesimit dhe nuk garanton parimin e përgjithshëm në fushën e të drejtës sipas të cilit në rastin kur një parashikim ligjor që rregullon një situatë të caktuar është e megjullt, dispozita do të interpretohet në favor të palës tjetër dhe jo të Shtetit.* Administrata prezumon “a priori” shkeljen e kryer nga ana e subjektit duke abuzuar edhe me “barrën e provës”, duke e vendosur këtë të fundit në pozitën për të provuar që nuk ka kryer shkelje, në vend që të ndodhë e kundërta, administrata të japë më parë prova dhe argumenta për shkeljen e kryer dhe më pas subjekti të jetë i detyruar të paraqesë kundër-argumentet apo provat e tij. Megjithatë, ligje të ndryshme si p.sh. Ligji Nr. 10433 datë 16.06.2014 “Për Inspektimin” kanë sjellë disa risi në sanksionimin e disa parimeve të së drejtës administrative që garantojnë në një nivel të lartë trajtimin e ndershëm nga ana e administratave inspektuese. Konkretisht, në këtë ligj, neni 8 “Parimi i dispozitës së favorshme ligjore” parashikon se: “1. Kur dispozitat ligjore, në bazë të të cilave vepron inspektimi, janë të paqarta

apo bien në kundërshtim me njëra-tjetrën, inspektori vepron në mënyrën që cënon më pak subjektin e inspektimit. 2. Kur subjekti i inspektimit ka vepruar në përputhje me një kërkesë ligjore që bie në kundërshtim me një kërkesë tjetër ligjore, veprimi i tij nuk do të konsiderohet në shkelje të ligjit”.

- » *Mungesë e infrastrukturës së përshtatshme për zhvillimin e seancave të shqyrtimit të ankimit administrativ për aq sa është e mundur në kushtet e solemnitetit dhe mbi bazë të parimeve të kontradiktoritetit.* Burime njerëzore të kufizuara për të ndjekur procedurat që lidhen me një fushë të gjerë veprimtarie si p.sh. ISHMT apo AKU të cilat pavarësisht vullnetit pozitiv të tyre, janë të kushtëzuara nga faktorët objektivë të mësipërm për të përmbushur të gjitha detyrimet që janë parashikuar në ngarkim të tyre nga legjislacioni përkatës.
- » *Mungesë e kapaciteteve të qëndrueshme të trajnuara dhe të azhornuara me legjislacionin, dinamikën e ndryshimeve të tij dhe të mbajtur me frymën e trajtimit të biznesit si partner.* Nga pothuajse të gjitha bizneset me të cilat Sekretariati ka zhvilluar takime, u ngrit shqetësimi lidhur me ndryshimin e shpeshtë të stafit në institucionet që ofrojnë shërbime për bizneset. Kjo sipas tyre sjell humbje të “kujtesës institucionale”, nevojën për kryerjen e trajnimeve të vazhdueshme dhe vonesa në kthimin e përgjigjeve nga këto institucione edhe për procedura të thjeshta dhe të konsoliduara tashmë, të cilat rritin

artificialisht numrin e mosmarrëveshjeve që krijohen midis bizneseve dhe administratës. Pakënaqësi ka mbi aftësitë profesionale të administratës dhe njohjen/përditësimin me legjislacionin, dinamikën e ndryshimeve të tij dhe njëkohësisht komunikimin e frymën e trajtimit të biznesit.


- » *Vetë bizneset nuk e njohin si duhet sistemin e ankimit administrativ ndaj akteve të administratës publike.* Në mjaft raste ata mjaftohen me ndjekjen e problematikave të tyre nëpërmjet ankesave të thjeshta apo kontakteve direkte, në rastin kur administrata kthen përgjigje me vonesë apo nuk kthen fare përgjigje, duke mos ndjekur procedurat dhe afatet për dorëzimin e ankimeve administrative formale. Këtu ka vend edhe për investime nga biznesi në rritjen e kapaciteteve të brendshme profesionale, për të njohur dhe respektuar si duhet procedurat e institucioneve lidhur me specifikat e ankimit administrativ si edhe parimet e Kodit të Procedurave Administrative.
6. *Nga ana tjetër, vendimet e Komisioneve të Ankimit përgjithësisht nuk publikohen veçanërisht në rastin e inspektoriateve.* Edhe kur publikohen si p.sh. në rastin e DAT që nuk është inspektoriat, publikimi i tyre nuk është sistematik. Sikurse është konstatuar në analizën e Sekretariatit “Për Përmirësimin e Mekanizmave të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve midis Biznesit dhe Administratës Publike”, publikimi i vendimeve të arsyetuara nga Komisionet e Ankimit (për referencë mund të merren vendimet e KPP) i hapin rrugë unifikimit adminis-

trativ të praktikës në zgjidhjen e rasteve të ngjashme në fushën e kontrollit/inspektimit, i japin subjekteve një panoramë të plotë mbi qëndrimet lidhur me çështje të veçanta apo specifike dhe e ngarkojnë administratën me “barrën” për t’i qëndruar interpretimeve të saj të dhëna më herët duke kufizuar diskrecionin e tepërt, që con në subjektivizma apo në marrjen e vendimeve arbitrare. Në këtë kuptim publikimi i vendimeve duhet të shikohet si një mundësi jo vetëm për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve, por edhe si një mekanizëm efektiv për korrigjimin e praktikave institucionale.

7. *Moszgjidhja e mosmarrëveshjeve me inspektoriatet ka rezultuar në një stok prej 2,179 çështje me palë bizneset dhe inspektoriatet që trajtohen nga Gjykata Administrative e Apelit (Fig. 7).* Statistika të Gjykatës Administrative të Apelit tregojnë se stoku i çështjeve po vjen gjithmonë e më shumë në rritje, ndërkohë që numri i çështjeve të reja me palë paditëse bizneset dhe palë e paditur inspektoriate ka ardhur në ulje. Theksojmë se një nga arsytet lidhet edhe me burimet e pamjaftueshme të Gjykatës Administrative të Apelit e cila është e përbërë nga vetëm 13 gjyqtarë si edhe larminë e çështjeve në kompetencë të kësaj gjykate. Në raport me numrin e përgjithshëm të çështjeve të mbetura në pritje të gjykimit (rreth 13.000 të tilla), numri i çështjeve që lidhen me inspektoriatet është i vogël. Një vështrim krahasues i numrit të çështjeve me palë paditëse biznesin dhe palë e paditur inspektoriatet, të shqyrtuara nga Gjykata e Apelit Administrativ jepet më poshtë.


26 Kodet miratohen me shumicë të cilësuar prej 3/5 e anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë.

Figura 7. Stoku i Çështjeve të Raportuara nga Gjykata e Apelit Administrativ




Në formë më të detajuar në Figurën 9 dhe Figurën 10 jepet shpërndarja e çështjeve të shqyrtuara sipas inspektoriateve të veçanta për vitin 2017 dhe 2018. Inspektoriatet që kanë numrin më të lartë të çështjeve gjyqësore janë ISHP-SHSH (40%) dhe ISHMPUT (19%), IKMT (28%) ISHSH (4%) në 2017 (shih Fig. 9). Në 2018, inspektoriatet me numrin relativ më të madh të çështjeve rezultojnë IKMT (40%),

Figura 8. Nr. çështjeve të reja të raportuara nga Gjykata e Apelit Administrativ




ISHPSHSH (23%), ISHMPUT (11%) dhe AKU (10%). Shpërndarja e çështjeve që kanë palë inspektoriatet, në gjykatën administrative të apelit, tregon për rritje të problematikave që kanë të bëjnë me sigurinë ushqimore, mjedisin dhe ujin. Marrëdhëniet e punës dhe siguria në punë, gjithashtu janë çështje të rëndësishme për vëmendjen e inspektoriateve dhe bizneseve.

Figura 9. Shpërndarja e Çështjeve të ndjekura nga Gjykata Administrative e Apelit me palë Inspektoriatet, 2017




8. Në analizë të raportit të çështjeve gjyqësore të fituara përkatësisht nga inspektoriatet dhe nga biznesi, që sigurisht varet edhe nga specifikat e çështjeve gjyqësore dhe inspek-

Figura 10. Shpërndarja e Çështjeve të ndjekura nga Gjykata Administrative e Apelit me palë Inspektoriatet, 2018



toriatet e veçanta, rezulton se mesatarisht për të gjitha inspektoriatet 62% e çështjeve është fituar nga inspektoriatet dhe 38% e çështjeve të fituara nga bizneset (shih Fig. 11).

Figura 11. Raporti i Masave të Shfuqizuara nga Gjykata Administrative e Apelit, 2016-2018*

Burimi: Përpunim i Sekretariatit

3. KOORDINIMI NDËR-INSTITUCIONAL

A. Portali unik e-inspektimi, mundësi për të rritur transparencën e inspektoriateve. Funksionimi i plotë i tij dhe përdorimi gjerësisht nga të gjitha inspektoriatet mbetet ende një sfidë.


IQ në bazë të Nenit 16 të Ligjit Nr. 10433 datë 16.06.2011, ka krijuar dhe administron portalin unik të inspektimit, që shërben për programimin dhe bashkërendimin e inspektimeve dhe shkëmbimin e të dhënave nëpërmjet inspektoriateve të ndryshme. Kuadri nënligjor mbi rregullat, procedurat, kompetencat dhe përmbajtjen e portalit e-inspektimi është tashmë i konsoliduar²⁷.

²⁷ Në lidhje me portalin unik të inspektimit janë miratuar aktet e mëposhtme:
VKM Nr. 696 datë 16.08.2013 "Për Përcaktimin e Procedurave

Portali ka standardizuar disa nga dokumentacionet paraprake të nevojshme për kryerjen e procedurave inspektuese në mënyrë transparente sikurse janë autorizimi i inspektimit apo listë-verifikimet (*check lists*) sektoriale sipas fushave të inspektimit dhe sektorëve specifikë. Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar duhet të bazohen në gjetjet e konstatuara gjatë verifikimit të *check-list*. Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar nënshkruhen nga trupat inspektuese dhe nga përfaqësuesi i subjektit që inspektohet, në vendin e inspektimit.


të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoriatit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik "e-Inspektimi";
Urdhër Nr. 15 datë 07.05.2015 i Inspektorit të Përgjithshëm "Për Miratimin e Rregullave Për Përcaktimin e Procedurave dhe Mënyrave, Për Përdorimin e Portalit Unik të Inspektimit "e-Inspektimi";
Urdhër i Inspektorit të Përgjithshëm Nr. 95 datë 16.02.2017 "Për Kryerjen e Inspektimeve Online"
Urdhër i Inspektorit të Përgjithshëm Nr. 284 datë 03.05.2017 "Për Kryerjen e Inspektimeve Online"

Nga të dhënat administrative të IQ, e-inspektimet janë rritur 3 herë në vitin 2017 krahasuar me 2016. Rreth 13.444 inspektime, ose 16% e inspektimeve janë kryer nëpërmjet inspektimit *online*. (shih Fig. 12). Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është inspektoriati që ka digjitalizuar procesin e inspektimeve, ndërsa inspektoriatet e tjera raportojnë një numër modest inspektimesh online kundrejt totalit të inspektimeve që kryejnë. Inspektimet *online* janë një mekanizëm transparence duke kufizuar diskrecionin e inspektorëve apo subjektivitetin e tyre gjatë inspektimit. Inspektimi *online* ndihmon në monitorimin e trupave të inspektimit në kohë reale.

Figura 12. Numri i inspektimeve online kundrejt totalit të inspektimeve

Burimi: Të dhëna administrative nga Raporti Vjetor 2017, Inspektoriati Qendror

Bizneset, të pyetur për të raportuar ndikimin e sistemit *online* të deklarimit të të dhënave të biznesit pranë autoriteteve tatimore kanë deklaruar se janë të kënaqur nga përdorimi i sistemeve *online* për deklarimin e informacionit dhe për besueshmërinë e informacionit. Vlerësimi i matur në një shkallë 1 (i pakënaqur) – 5 (shumë i kënaqur) tregon se bizneset janë mjaft të kënaqur nga përdorimi i shërbimeve *online*. Shkalla e kënaqësisë dhe lehtësisë në përdorimin e këtyre sistemeve është më e ulët mes bizneseve të vogla dhe në disa prej zonave më pak të zhvilluara, për të cilat mungesa e informacionit dhe e kapaciteteve njerëzore për t'i përdorur mund të sjellë kosto shtesë dhe problematika në përputhshmëri. Ndërgjegjësimi dhe informimi i biznesit në këto raste është i domosdoshëm.

Figura 13. Shkalla e vlefshmërisë së sistemeve online të inspektimit tatimor e raportuar nga biznesi

Burimi: Anketimi i Klimës së Investimeve 2018, Sekretariati, Këshilli i Investimeve

Nga takimet e realizuara me biznese dhe përfaqësues të inspektoriateve, rezulton se ka një qasje të re nga ana e disa inspektoriateve, për të ndërgjegjësuar bizneset lidhur me plotësimin e kërkesave të check-listave duke ju lënë para-prakisht afat korrigjimi (si p.sh. në rastin e inspektimeve të kushteve të punës nga ISHPSHSH apo të kushteve të tregtimit të mishit nga AKU) dhe më pas duke i inspektuar. Inspektimet *online* zënë vetëm 16% të numrit të inspektimeve të kryera nga të gjitha inspektoriatet. Sikurse konstatohet edhe në raportet vjetore të IQ, *inspektimi online ende nuk po gjen zbatimin e duhur në praktikë nga të gjitha inspektoriatet*²⁸.

B. Unifikimi dhe Standardizimi i Procedurave të Inspektimit si garanci për dokumentimin ligjor të veprimtarisë inspektuese.

IQ me Urdhërin Nr.58, datë 21.8.2014 dhe Rregulloren e posaçme ka miratuar formatet standarde për dokumentimin e veprimtarisë inspektuese, për të gjitha inspektoriatet:

1. Autorizim Inspektimi
2. Procesverbal Inspektimi;
3. Vendim i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente;
4. Vendim përfundimtar inspektimi;
5. Vendim për zgjidhjen e ankimit të veçantë;
6. Autorizim për ndryshimin e inspektorëve;
7. Kërkesë për refuzim të autorizimit të inspektorit;
8. Kërkesë për shtyrje të autorizimit të inspektimit;
9. Vendim për shtyrje të autorizimit të inspektimit;

10. Vendim i Komisionit të Ankimit.

11. Karta e Inspektorit.

C. Koordinimi institucional midis organeve inspektuese për kryerjen e inspektimeve të përbashkëta, kusht thelbësor për rritjen e efektivitetit të inspektimeve dhe uljen e barrës për bizneset. Ndonëse ka përmirësime, bashkëpunimi mbetet sporadik dhe në varësi të vullnetit të titullarëve të institucioneve. Të dhënat administrative tregojnë se numri total i inspektimeve është ulur, megjithatë ndryshimi i kompetencave të inspektoriateve dhe koordinimi mund të përmirësojë efikasitetin e monitorimit dhe rolit garantues të tregut që kanë inspektoriatet. Më konkretisht:

- » *Ligji Nr.10433 datë 16.06.2011 "Për Inspektimin", ka vendosur një garanci të rëndësishme për subjektet e inspektimit, duke e kufizuar kohën në dispozicion të ISH për të kryer inspektime pranë këtyre subjekteve. Konkretisht, në nenin 26/2 është parashikuar që "...kohëzgjatja maksimale e lejuar e inspektimit vjetor është nga 5 deri në 15 ditë". Qëllimi i këtij parashikimi ligjor është jo vetëm të garantojë barrë të ulët për bizneset, por nga ana tjetër edhe të nxisë bashkëpunimin dhe koordinimin institucional për të mundur që kohëzgjatja maksimale e inspektimeve të mos tejkalojë 15 ditë. Në praktikë inspektimet e përbashkëta nuk kanë gjetur shumë përhapje dhe planet e inspektimit*

të ISH nuk janë koordinuar si duhet. Kjo akoma mbart një barrë për bizneset të cilat qoftë edhe në periudha të shkurtra kohore kanë qenë subjekte të inspektimeve nga disa inspektoriate. Koordinimi i mësipërm është funksion i IQ, i cili duhet të mundësojë bashkërendimin e inspektimeve të programuara mbi bazën e programeve vjetore dhe mujore të depozituara paraprakisht nga inspektoriatet.

- » *Mungesa e koordinimit institucional konstatohet edhe midis inspektoriateve dhe organeve të tjera me funksione kontrolli jashtë sistemit të inspektoriateve, por që kanë funksione shumë të rëndësishme në kuadër të evidentimit të aktiviteteve informale dhe mbrojtjes së konkurrencës së ndershme.* Konkretisht, subjekt i inspektimit nga AKU janë jo vetëm subjektet e regjistruara në bazë vullnetare në QKB me NUIS si tregtarë dhe rrjedhimisht si tatimpagues pranë organeve tatimore, por edhe subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet tregtar pa qenë fare të regjistruar si p.sh. tregtarët e gjësë së gjallë apo njësitë e shitjes së mishit të therur. Kategoria e këtyre subjekteve të cilat kanë qenë subjekt i kontrollit nga AKU për shkak të shkeljeve të elementeve që lidhen me sigurinë ushqimore, janë raportuar nga AKU në organet tatimore si subjekte totalisht informale dhe të paregjistruara. Pavarësisht këtij raportimi, këto subjekte janë identifikuar sërish në kontrollet e radhës nga AKU si subjekte të paregjistruara dhe jashtë fokusit

të masave nga administrata tatimore. Për më tepër nga AKU konfirmohet se nuk kanë marrë në asnjë rast një njoftim zyrtar në lidhje me masat e ndjekura nga administrata tatimore për këto subjekte dhe as nuk janë bashkërenduar kontrolle/inspektime të përbashkëta. Një mungesë e tillë koordinimi vihet re edhe në raport me inspektoriatet apo organet e njësisve vendore të ngarkuara me funksione inspektuese, të cilat edhe kur konstatojnë shkelje nga pikat e tregtimit në lidhje me kushtet higjeno-sanitare apo subjekte informale dhe të paregjistruara nuk raportojnë këtë fakt pranë inspektoriatit përkatës apo organit tatimor, por në të kundërt legjitimojnë informalitetin duke vjelë nga subjekti vetëm taksën/tarifën lokale.

- » *Sekretariati nënvizon një fakt i cili është konfirmuar edhe në rastet e trajtimit të çështjeve të tjera në KI (bujqësia, turizmi, BPO) që institucionet e shtetit priren të kontrollojnë apo inspektojnë vetëm subjektet të cilat janë të regjistruara, duke lënë shpesh jashtë fokusit subjektet që operojnë në informalitet të plotë dhe jashtë regjistruarve institucionalë.* Kjo në praktikë ka sjellë deformime të tregut dhe konkurrencës së ndershme dhe nga ana tjetër ka rritur padrejtësisht barrën administrative dhe fiskale vetëm për pjesën që është e regjistruar. Bizneset në të përditshmen e tyre raportojnë konkurrencën nga aktiviteti informal apo tregu i parregulluar si një nga barrierat kryesore të të bërit biznes apo të nxitjes së investimeve.

REKOMANDIME

Bazuar në sa më lart, mund të konkludojmë se kemi një progres (ndonëse jo në ritmin e parashikuar) të Reformës së Inspektimit shfaqur në uljen e numrit të inspektoriateve, reduktimin e numrit të ditëve të inspektimit në biznese, standardizimin e procedurave të inspektimit, prezantimin e inspektimit *online* dhe publikimin e listave të inspektorëve. Ndërkohë, analiza sjell në vëmendje problematika që kanë ulur ritmin e reformës kundrejt sfidave aktuale të ekonomisë shqiptare, në kuadër të integritetit në BE si edhe përballjes me konkurrencën rajonale dhe ndërkombëtare.

REKOMANDIM 1.

Progresi i mëtejshëm, si pjesë e reformës derregullatore kërkon një moment reflektimi dhe vlerësimi të impaktit të deritanishëm, duke saktësuar sukseset dhe prioritizuar ndërhyrjet e integruara të reformës me reformat e tjera strukturore si ajo e administratës publike dhe shërbimit civil.

Vijueshmëria e fokusit të reformës dhe angazhimi politik mbeten parakusht duke pasur parasysh kompleksitetin e thellimit të reformës në anën përmbajtësore të saj, kompleksitetit në aspektin teknik të inspektimit, përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së, rritjen cilësore të kapaciteteve të burimeve njerëzore, forcimin dhe akreditimin e kapaciteteve teknike-laboratorike me kostot përkatëse. Mekanizmi i konsultimit me biznesin të integrohet në mënyrë të strukturuar dhe të jetë pjese e RIA-s, për të qartësuar efektet e pritshme të ndryshimeve rregullatore për palët e ndikuara, sidomos për biznesin.

REKOMANDIM 2.

Konsolidimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional ka rëndësi prioritare për suksesin e kësaj reforme, veçanërisht në drejtim të zbatimit të kërkesave rregullatore që garantojnë konkurrencë të ndershme midis operatorëve në treg dhe formalizim të sektorëve të ekonomisë. Ky bashkëpunim merr rëndësi të veçantë edhe në kuadrin e luftës ndaj informalitetit ku roli i funksioneve inspektuese si DPD, DPT, IshPSHSh, AKU dhe ISHMT etj. ka impakt mbi funksionimin e tregut. Për këtë, angazhimi i qartë institucional i ministrive të linjës (drejtorive përkatëse ekzistuese ose të reja), si përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave dhe legjislacionit të zbatuar nga inspektoriatet është i domosdoshëm. Ky angazhim është pjesë e rëndësishme e koordinimit institucional mes Ministrive, Inspektoriatit Qendror dhe Inspektoriateve Shtetërore si faktor sukcesi i reformës.

REKOMANDIM 3.

Përgatitja e një matrice të detajuar me të gjitha funksionet inspektuese dhe mbivendosjeve si fazë fillestare e hartimit të një plani konkret me afate kohore, institucione përgjegjëse, metodologji të qartësuar në lidhje me rishikimin e kuadrit ligjor sektorial nga ana e Ministrive të Linjës, në bashkëpunim me Inspektoriatin Qendror dhe Inspektoriatet Shtetërore. Progresi i reformës në drejtim të përmirësimit të legjislacionit sektorial i shërben axhendës së integritetit në BE. Shmangia e mbivendosjes së inspektimeve si rezultat i rishikimit të ligjeve sektoriale dhe qartësimit të kompetencave si në nivelin e inspektoriateve shtetërore ashtu edhe atyre vendore do të sjellë rritjen e eficiencës së inspektimit drejt shkallës optimale. Ulja eventuale e numrit të inspektoriateve dhe e bashkimit të funksioneve të tyre sipas objektit të in-

spektimit nuk duhet të kushtëzojë zbatimin e funksioneve monitoruese dhe rregullatore që garantojnë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të konkurrencës së drejtë midis bizneseve.

REKOMANDIM 4.

Inventarizimi i plotë i kuadrit ligjor-rregullativ të inspektimit dhe bërja i aksesueshëm lehtësisht i tij për të gjitha grupet e interesit (biznese, shoqata, inspektorë) do të përmirësojë efikasitetin e inspektimeve si edhe do të forcojë rolin rregullator/mbikqyrës të inspektimeve duke ulur kostot e përputhshmërisë së biznesit.

REKOMANDIM 5.

Asistencë ligjore falas dhe në distancë për subjektet e inspektimit nga ana e trupave inspektuese nëpërmjet përgatitjes së manualeve të thjeshta për rubrika të veçanta, sipas tipologjive të inspektimit dhe karakteristikave të bizneseve. Reformimi i inspektimit ka qenë dinamik, procedurat dhe praktikat janë rishikuar dhe standartizuar. Këto ndryshime ndiqen lehtë nga bizneset e mëdha, por me vështirësi nga bizneset e vogla dhe të mesme. Struktura e ekonomisë sonë dominohet nga bizneset e vogla dhe të mesme, me kapacitete të kufizuara, për të cilat ndihma dhe këshillimi është i nevojshëm. Asistenca ligjore në modelin e një shërbimi call-center/numër i gjelbër për subjektet e inspektimit do të lehtësonte procesin e përputhshmërisë së bizneseve me ligjet/kuadrin rregullativ.

REKOMANDIM 6.

Përmirësimi (përgatitja në ato raste që mungon) dhe përditësimi i metodologjive të riskut mbi bazën e të dhënave më të fundit të monitorimit sipas sektorëve do të rrisë eficiencën e inspektimeve dhe ulë barrën për bizneset. Struktura e bizneseve në vend është

e segmentuar me tipologji të njësive të vogla tregtare apo në fushën e shërbimit. Ndërkohë kapacitetet administrative janë të kufizuara si në burime njerëzore dhe financiare. Për këtë arsye, përgatitja e bazave të të dhënave sektoriale nga çdo inspektoriat dhe identifikimi i riskut të çdo aktiviteti mbi bazën e kriterëve objektive, do të mundësonin inspektime efektive dhe me shpërndarje kohore të arsyeshme. Kriteret e riskut duhet të jenë të përcaktuara në legjislacionin sektorial, ndërkohë që institucionet e administratës publike duhet të mbajnë statistika sistematike dhe të strukturuar.

REKOMANDIM 7.

Përgatitja/përmirësimi dhe bërja publike e metodologjive të aplikuara nga inspektorët për vendosjen e masave administrative të përshtatshme dhe proporcionale, konsiderohet si një mjet për të kufizuar vendimet arbitrare dhe selektive. Standardizimi i procedurave të inspektimit e bën të domosdoshme hartimin dhe standartizimin e metodologjive për vendosjen e masave administrative, duke përdorur parimin e proporcionalitetit në raport me dëmin ekonomik/pasojën e shkaktuar nga shkelja e kryer. Për këtë qëllim në përmbyllje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Neni 48, pikat 7 dhe 8, të Ligjit Nr. 10433, Këshilli i Ministrave/IQ duhet të miratojë Rregulloren e Përgjithshme mbi Metodologjinë e Vendosjes së Dënimeve Administrative, ndërsa inspektoriatet shtetërore dhe vendore metodologjitë përkatëse për dënimet administrative në fushën e tyre të inspektimit²⁹.

29 ISHPSHSH është inspektoriat i parë shtetëror i cili ka përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare të institucionit një [matricë](#) mbi vendimmarrjen e inspektorëve dhe masat administrative të parashikuara për secilën shkelje specifike të legjislacionit të punës. Matrica mbështetet nga një metodologji që garanton masa administrative proporcionale në raport me shkeljen e kryer, nxit transparencën dhe kufizon praktikën arbitrare të inspektimit dhe të vendosjes së dënimeve

REKOMANDIM 8.

Përfundimi i listë-verifikimeve për funksionet e inspektimit të inspektoriateve në nivel vendor dhe kryerja e këtyre inspektimeve në mënyrë online sikurse dhe inspektimet nga inspektoriatet shtetërore.

REKOMANDIM 9.

Rritja e numrit të inspektimeve të programuara gjatë 2019 me objektivin për të patur një raport 85% me 15% midis inspektimeve të programuara dhe atyre të paprogramuara. Fokusi i inspektimeve duhet të jetë këshillimi dhe asistimi i biznesit për të ndihmuar përputhshmërinë e tij me standardet, dhe masat administrative duhet të konsiderohen si hallka e fundit për arritjen e qëllimeve të inspektimit.

REKOMANDIM 10.

Qëndrueshmëri dhe trajnimi i stafit të inspektoriateve. Motivimi i trupave inspektuese, testimi periodik i tyre dhe vlerësimi i performancës mbi kriteret të mirëpërcaktuara. Programe trajnimi të stafit të inspektoriateve dhe veçanërisht për komisionet e shqyrtimit të ankimeve në lidhje me funksionet e inspektimit dhe standardet sektoriale të kërkueshme nga ana e legjislacionit.

REKOMANDIM 11.

Të forcohet dhe strukturohet komunikimi me biznesin në funksion të transparencës dhe përputhshmërisë me standardet sektoriale të përputhshmërisë dhe procedurat e inspektimit. Mungesa e konsultimit paraprak me bizneset në një sërë ini-

duke rritur ndërgjegjësimin e vetë punëdhënësve për t'u vetëkorrigjuar, si edhe vendos premisa pozitive për të garantuar trajtim të barabartë për punëdhënësit pavarësisht segmentit të biznesit ku ata operojnë. Përgatitja e një metodologjie/matricë të tillë ka qenë edhe një [rekomandim i mëparshëm](#) i Sekretariatit të KI:

ciativash është bërë burim i mosmarrëveshjeve administrative të cilat janë trajtuar nga strukturat apeluese të vetë institucioneve apo dhe Gjykatat Administrative. Vlerësohet se ekzistenca e këtyre mekanizmave do të mundësonte nxitjen e dialogut midis palëve dhe uljen e kostove për biznesin. Ndërkohë vetë *operatorët ekonomikë duhet të ndërgjegjësohen për sfidat që lidhen me përmbylljen e detyrimeve dhe standardeve në kuadër të përafrimit* të legjislacionit me *acquis*, dhe duhet të jenë proaktiv në hartimin dhe diskutimin e legjislacionit sektorial.

REKOMANDIM 12.

Unifikimi i praktikave administrative nëpërmjet publikimit të komentareve. Në këndvështrimin e bizneseve, ekspertëve dhe grupeve të interesit të kontaktuar nga Sekretariati, unifikimi i praktikave të konsoliduara shikohet si një ndër elementët më të domosdoshëm, të cilët do të reduktonin në një masë të konsiderueshme numrin e ankimeve ndaj vendimeve të administratës tatimore dhe përmirësimin e treguesit të perceptimit të bizneseve lidhur me të. Një rol shumë të

rëndësishëm në unifikim mund të luajë edhe Avokatura e Shtetit, nëpërmjet rolit të saj aktiv me interpretime për çështje ligjore me karakter përgjithësues për të gjithë administratën publike. Për këtë janë të nevojshme edhe ndryshime ligjore në Ligjin Nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”.

REKOMANDIM 13.


Sugjerohet që të ketë një *unifikim dhe centralizim të apelimit të Inspektoriateve në Inspektoriatin Qendror për të rritur profesionalizmin, pavarësinë dhe besimin e ankimit në Inspektoriatet Shtetërore, si edhe zhvillimin e seancave dëgjimore gjatë shqyrtimit të ankimeve administrative.* Komisionet përgjegjëse për shqyrtimin e ankimeve të kenë në përbërje të tyre ekspertë të fushës konkrete të inspektimit dhe përfaqësues të ISH që ka vendosur masën administrative. Modalitetet dhe procedurat e ndjekura të përcaktohen me një rregullore të veçantë dhe të jetë publike në faqen e IQ dhe çdo ISH. Për këtë është e nevojshme të bëhen ndryshime në ligjin nr. 10433 datë 16.06.2014 “Për Inspektimin”.

SHTOJCA


Shtojca 1. Të dhëna të përgjithshme për kampionimin e bizneseve të përfshira në anketim

Pyetjet	Kategoria e përgjigjes	Frekuenca (në nr)	Frekuenca në (%)
Rajonet	Rajoni Juglindor	67	19.4%
	Rajoni Jugor-Bregdetar	112	32.4%
	Rajoni Qendror (Tirana)	123	35.5%
	Rajoni Verior	44	12.7%
Xhiroja Vjetore	Kategoria e përgjigjes	Frekuenca (ne no)	Frekuenca në (%)
	Deri në 8 Mio Lek	197	59.3%
	Mbi 8 Mio Lek	135	40.7%
Numri i Punonjësve	Kategoria e përgjigjes	Frekuenca (ne no)	Frekuenca në (%)
	Deri në 50 të Punësuar	232	69.7%
	Mbi 50 të punësuar	101	30.3%


Rajonet/Qarku	Kategoria e përgjigjes	Frekuenca (ne no)	Frekuenca në (%)
	Berat	6	1.7%
	Dibër	5	1.4%
	Durrës	51	14.7%
	Elbasan	9	2.6%
	Fier	14	4.0%
	Gjirokastër	15	4.3%
	Korçë	37	10.7%
	Kukës	4	1.2%
	Lezhë	11	3.2%
	Shkodër	24	6.9%
	Tiranë	123	35.5%
	Vlorë	47	13.6%
Autoriteti Tatimor/ Inspektimi	Kategoria e përgjigjes	Frekuenca (ne no)	Frekuenca në (%)
	Pa përgjigje	13	3.8%
	Drejtori Rajonale	285	82.4%
	Tatimpagues i Madh	48	13.9%
Aksionerët	Kategoria e përgjigjes	Frekuenca (ne no)	Frekuenca në (%)
	Pa Përgjigje	95	27.5%
	Kapital vendas	215	62.1%
	Kapital i përbashkët	19	5.5%
	Kapital i huaj	17	4.9%
Sektorët	Kategoria e përgjigjes	Frekuenca (ne no)	Frekuenca në (%)
	Industri	18	5%
	Ndërtim	20	6%
	Tregti	44	13%
	Telekomunikacion, transport, magazinim	88	26%
	Hospitaliteti/Ushqime/Pije	89	26%
	Shërbime financiare, sigurimet, profesionale	35	10%
	Shërbime të tjera (low skilled)	51	15%

Shtojca 2. Perceptimi i Biznesit për Klimën e Investimeve 2018


Burimi: Anketa e Klimës së Investimeve 2018

Shtojca 3. Vlerësim i mesatarizuar i perceptimit të biznesit për Klimën e Investimeve (shkalla e vlerësimit 1- shumë jo favorizuese, 5- shumë favorizuese)

Burimi: Anketa e Klimës së Investimeve 2018

Shtojca 4. Prevalenca e inspektimeve, vizitave dhe kontrolleve tatimore


Burimi: Anketa e Klimës së Investimeve 2018

Shtojca 5. Raporti Gjorbë/Masë Administrative për 2017 (në %)*

Burimi: Përpunimi i Sekretariatit, Të dhëna nga Raporti Vjetor 2017 i Inspektoriatit Qendror

Shënim: Norma 100% e raportit gjorbë/masë administrative nënkupton se gjithë masat administrative të raportuara kanë qënë gjoba. Raporti më i lartë i gjobave kundrejt masave administrative raportohet për IKMT, ISHSH dhe ISHMPU. Në këtë grafik janë përmbledhur vetëm inspektoriatet që kanë raportime të plota dhe peshën kryesore në volumnin e inspektimeve.

Shtojca 6. Shpërndarja e gjobave sipas inspektorateve në 2017 (në %)



Burimi: Përpunimi i Sekretariatit, Të dhëna nga Raporti Vjetor 2017 i Inspektoriatit Qendror

BIBLIOGRAFIA

1. *Busse and Groizard (2008)*
2. *EB- "Business Environment Reform & Institutional Strengthening (BERIS) 2007-2012"*
3. *EU Progress Report (2018)*
4. <http://www.e-inspektimi.gov.al/SitePages/Home.aspx>
5. <http://www.insq.gov.al/?lang=en>
6. *Ligji Nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; dispozitat konkrete të VKM-ve përkatëse në bazë të të cilave krijohen, organizohen dhe funksionojnë inspektoratet përkatëse si edhe dispozitat e ligjeve material të zbatuara nga ana e secilit inspektorat*
7. *Best Practice Principles on Stakeholder Engagement in Regulatory Policy (2017), OECD*
8. *Raportet Vjetore (2013-2017), Inspektoriatit Qendror*
9. *The Role of Inspections in the Enforcement of Legislation with Main Focus on Business Related Inspection in Serbia, Andreja Marusic, Slvica Penev (2011)*
10. *Urdhër i Inspektorit të Përgjithshëm Nr. 284 datë 03.05.2017 "Për Kryerjen e Inspektimeve Online"*
11. *Urdhër i Inspektorit të Përgjithshëm Nr. 95 datë 16.02.2017 "Për Kryerjen e Inspektimeve Online"*
12. *Urdhër Nr. 15 datë 07.05.2015 i Inspektorit të Përgjithshëm "Për Miratimin e Rregullave për Përcaktimin e Procedurave dhe Mënyrave, për Përdorimin e Portalit Unik të Inspektimit "e-Inspektimi"*
13. *Urdhëri Nr. 25 datë 10.08.2018 të Inspektorit të Përgjithshëm*
14. *VKM Nr. 338 datë 06.06.2018*
15. *VKM Nr. 696 datë 16.08.2013 "Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoriatit Qendror dhe të Rregullave për Përmbytjen dhe Administrimin e Portalit Unik "e-Inspektimi"*

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjëse për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council